



Datë 23.01.2025

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.26/350-65578

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe hqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrërimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 e që nuk është në kundërshtim me PZHK 2021-2029, 01Nr.016-67691 datë 29.10.2021, si dhe neneve 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA Nr.05/L-031, DUPM në Suharekë lëshon këtë:

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Driton Limon Gashi N.T.P “Fat-Mani”	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore 07Nr.350/65578 datë 27.11.2024

Emri i Projektit:	Fermë për Majmëri të Viçave P+0
Emri i Projektuesit:	95 Studio
Adresa:	General Wesley Clark, Pejë

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA I – Leje e Përkohshme			
Adresa: Rr.”Mulliri Destanit”- Studençan, Komuna Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Studençan	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Çertifikata me Nr.ref.3891/2024 e datës 27.11.2024 pronë e Driton Limon Gashi	1719-0, 1720-0 2135m²	Y= 7481924.717 Y= 7481936.240 Y= 7481927.865 Y= 7481916.342	X=4690369.161 X=4690372.511 X=4690401.319 X=4690397.969

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Fermë për Majmëri të Viçave - konstruksion metalik montazh P+0			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I			
Gabariti:	(30.00m’ x 12.00m’)	Etazhiteti:	P+0
Vija rregullative:	Sipas Kushteve Ndërtimore 07Nr.124/350-12911 datë 08.03.2024	Vija ndërtimore:	Sipas Kushteve Ndërtimore 07Nr.124/350-12911 datë 08.03.2024

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore të përkohëshme Driton Limon Gashi nga Studençani, për Leje Ndërtimore për ndërtimin e objektit me destinim fermë për majmërinë e viçave. Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela kadastrale 1719-0 dhe 1720-0 ZK Studençan, është Zonë Bujqësore (Zb) me shfrytëzimet e lejuara të veçanta edhe për infrastrukturë bujqësore (Fermat) – në këtë rast fermë për majmërinë e viçavev. Objekti ka karakter të përkohshëm, ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUPM e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhese 360m². Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore.
 - Informata mbi Projektuesin.
 - Informata mbi Kontraktuesin.
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit.
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent.
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit.
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.
 - Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit.
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
- Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar të ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0.1)

metër por që nuk tejkalonjë vijën ndërtimore.

- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi Driton Limon Gashi nga Studençani, përmes kërkesës 07Nr.350/65578 datë 27.11.2024, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim destinim fermë për majmërinë e viçave - Konstruksion metalik montazh me etazhitet P+0, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Akvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.124/350-12911 datë 08.03.2024 (kopje),
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.59/24, datë 14.03.2024 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqimin nga Kompania regjionale e ujësjellësit dhe kanalizimit KRU "Hidroregjioni Jugor"- Sh.A.-Prizren datë 14.03.2024,
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.68 datë 15.03.2024,
- Pëlqim parimor nga KEDS-SH.A, Nr.319, datë 19.03.2024,
- Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent nr.0003976/24 datë 16.12.2024,
- Pëlqim Mjedisor VNM SP-02, 3481-2/24 datë 18.11.2024,
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terrenit me numër të lëndës 81/2024 të datës 26.11.2024 të punuar nga gjeodeti i licensuar Adriatik Fetiu,
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë,
- Kopje e dokumentit Identifikues,
- Në bazë të rregullores për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale në Komunën e Suharekës 01Nr.110-79262 datë 22.12.2023, neni 22 pika4, parashtruesi i kërkesës Driton Gashi lirohet nga taksa.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.26/350-65578 datë 23.01.2025

Vendimi i dërgohet: Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; DSHPJK-së; Dosjes së DUPM-së

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI